



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:225007

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06508668

2024:225008

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.L., për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1195/24, të datës 14.08.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 13.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarit D.S. dhe përfaqësuesit të tij me autorizim av.Behar Ejupi, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av. Elmaz Zenuni, me dt.14.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 19.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh.L., nga i ati R., e ëma S., e gjinisë G., i lindur më datë . në fshatin Komuna Hani Elezit, me vendbanim në rrugën “....“ në Ferizaj, ndërtesat e Nderimit kati .. nr. ., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer fakultetin ekonomik, i martuar baba i një fëmije, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datën 16.07.2024, në fshatin Komuna Ferizaj, i pandehuri me qëllim të dëmtimit të pasurisë së të dëmtuarit D.S., në tokën bujqësore në ngastrën kadastrale me numër P-....., me sipërfaqe 8745m², pronë e të dëmturit, ka hedhur disa kamionë të përzier me gur dhe i ka vendos shiritat rreth rrugës me pretendimin se prona është e tij, pa e lajmëruar apo pa e pyetur askënd.

Me çka ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 321 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € / katërqind euro /, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do të i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë Euro/, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, të gjitha në afatin brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

I dëmtuari D. Xh. S. nga Ferizaj , rr. “.....” , për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1195/24, e datës 14.08.2024, ka ngarkuar të pandehurin, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 13.11.2024, në të cilën seancë kane prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe përfaqësuesit të tij me autorizim, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij me autorizim.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare dhe ate pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin tim, ndihem thellë i penduar por nuk kam pasur zgjidhje tjetër, prona është ende në emër të dëmtuarit por unë kam pretendime se ajo është imja dhe përmes mbrojtësit tim unë do të ngre padi para gjykatës kompetente lidhur me këtë pronë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi, nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale që e ngarkon kjo aktakuza, pasi që një pranim të tillë i njëjti e bëri vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë pasi që një pranim i tillë mbështet në provat dhe faktet që i përmban kjo aktakuzë. Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin në kuptim të nenit 69 dhe 70 të merr parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese ku si rrethanë rënduese të marr shkallën e përgjegjësisë penale të

pandehurit, motivin e kryerjes së veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaron se ne pajtohemi me deklarinimin e prokurorit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe i propozojmë gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh se veprimet e të akuzuarit të cilat e kanë shqetësuar shumë të dëmtuarin dhe si rezultat i këtyre shqetësimeve është krijuar një pasiguri, ka përjetuar stres dhe se i propozojmë gjykatës që të njëjtit ti shqiptoj një dënim të merituar ashtu siç parashihet me ligj, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike pasi që është e ligjshme normal që do të paraqesim.

I dëmtuari deklaroi se e përkrahi në tërësi atë që deklaroi përfaqësuesi im dhe më tepër nuk kam çka të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaron se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, është këshilluar mjaftueshëm me mua, ka qenë konkret në pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë, ndërsa gjatë shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të shqiptohet një vërejtje gjyqësore sepse plotësohen kushtet ligjore nga neni 86 i KPRK-së për faktin se sanksioni penal është i ulët deri në një vit si dhe do të ishte i mjaftueshëm si sanksion penal për çështjen konkrete, kjo për faktin se është e mundur që tani i akuzuari – i mbrojturi im të vazhdoj procedurën gjyqësore përkitazi me kontestin rreth pronësisë e hipotetikusht nëse ajo pronësi ndaj të cilës pretendon i mbrojturi im do të vërtetohet se i përket atij atëherë çdo dënim tjetër jashtë vërejtjes gjyqësore do të ishte i ashpër dhe i pa justifikueshëm për arsye se nëse vërtetohet se prona i përket të mbrojturit tim çdo dënim tjetër është i pa arsyeshëm. Mendoj se gjykata e ka për bazë edhe personalitetin e të mbrojturit tim se së paku me asnjë aktgjykim të formës së prerë nuk është dënuar për vepër penale përveç ndonjë kundërvajtje në trafik dhe i premtton se realizimin e të drejtave të tij do ta bëj në mënyrë kompetent e jo në mënyrë arbitrare.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe

atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Deklaratën e të dëmtuarit D.S., e dhënë në Polici me datë 18.07.2024, Deklaratën e të pandehurit Sh.L. e dhënë në Polici me datë 19.07.2024, Raporti i Policisë Hetues i datës 23.07.2024, Raporti i Oficerit i datës 19.07.2024, Kopja e Planit, Certifikata e pronësisë me nr. e datës 18.07.2024, Katër Fotot A4 të bëra në vendin e ngjarjes si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autoritetin e saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:225008, datë 19.11.2024**

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.